



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2022

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “**INSTANT.AL**” sh.p.k me adresë: Tiranë, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i parë, Shqipëri.

Procedura e prokurimit: “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-44536-10-05-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Rinovim Licensa Antivirus SEP 14 (Symantec endpoint protection)**”, me fond limit: **2.000.000** (dymilion) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për lëvrimin e mallit **20 ditë nga data e lidhjes së kontratës**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “INSTANT.AL” sh.p.k me Nipt: L81506043D

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,700,000** (një milion e shtatëqind mijë) lekë (pa tvsh).

2. “ARTAN LLOZANA” sh.p.k me Nipt: K32731239W

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,985,000** (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë (pa tvsh).

3. “EURO INFORM” shpk me Nipt: K33721008C

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1,625,000** (një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë) lekë (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. “EURO INFORM” shpk

- Në përmbushje të kapacitetit teknik, kushti 2.3.1 : Operatori Ekonomik për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, fatura e ngjashme, nuk plotëson kushtin 2.3.1.

- Operatori Ekonomik në përmbushje të pikës 2.3.2 të kapacitetit Teknik : Në rast se Operatori Ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar për Antivirus SEP 14 (Symantec Endpoint Protection)

Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri, dokumenti është i papërkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Oferta e operatorit ekonomik “EURO INFORM” sh.p.k s’kualifikohet për arsyen e mesiperme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **"INSTANT.AL"** sh.p.k me adresë: Tiranë, Rruga Idriz Dollaku, Ali demi, Apartamenti 2, shkalla 1, kati i parë, Shqipëri, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **1,700,000** (një milion e shtatëqind mijë) lekë (pa tvsh), është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari
Aulona Bylykbashi**